



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:242433

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05645361

KPPP.nr. 330/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A - Vala, me seli në Prishtinë, kundër debitorit S+H+GMBH Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, rr. “Ahmet Sëllaci”, nr. 1, me bazë përmbarimi sipas dokumentit të besueshëm, pas shqyrtimit paraprak të lëndës, jashtë seancës, me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A. - Vala, me seli në Prishtinë, kundër debitorit S+H+GMBH Sh.P.K., me seli në Mitrovicë.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Aktvendimin E.nr. 653/10, të datës 11.11.2010, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit për pagesën e detyrimit sipas dokumentit të besueshëm në lartësi prej EUR 293.78. Ndërsa, e njëjta gjykatë me aktvendimin E.nr. 653/10, të datës 23.09.2016 është

shpallur jo kompetente për të vendosur në këtë çështje përmbarimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin CP.nr. 302/16, të datës 02.11.2022, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje, ndërsa lënda i është dërguar Gjykatës Komerciale në Prishtinë, si gjykatë kompetente për të procedura në këtë çështje përmbarimore.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbarimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbarimit sipas aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbarimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së. Andaj, në mungesë të mjetit juridik, në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit

për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarimore.

Duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbarimore është caktimi dhe zbatimi i aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit nga gjykata si organ përmbarues, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht G Gjykata Themelore Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 330/24, datë 02.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.